



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.15, datë 13.01.2020

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË FUNKSIONIT DHE NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË NDËRTIMIT TË OBJEKTIT: “NDËRTIMI I KOMPLEKSIT TURISTIK “41°N19° E”, ME VENDNDODHJE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHËM, BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 12 dhe 17, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “MW Plan” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të funksionit dhe ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit të objektit: “Kompleks turistik “41°N19°E”, me vendndodhje në Njësinë Administrative Ishëm, Bashkia Durrës, me zhvillues shoqërinë “MW Plan” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.14, datë 28.07.2016, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

E D I R A M A



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT


BLENDI KLOSI



~~ANËTAR / SEKRETAR I KKT~~

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

